

Raporti nga Projekti

Qytetaria Aktive

Projekt: “Active Citizens”
(Qytetaria Aktive)

Autor:
Besnik Tahiri, MA

Trajnues:
Fatmir Haxholli, MA dhe Burim Leci MA

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
www.klg-institute.org

Prishtinë
15 janar, 2013

I. Përmbajtja

II.	Përmbledhja e Përgjithshme	3
III.	Prezantimi i Moduleve	5
IV.	Vizita studimore në Bradford të Anglisë	10
V.	Roli i nismave qytetare në ngritjen e Qytetarisë Aktive:	12
VI.	Përshtypjet e pjesëmarrësve	17
VII.	Storjet e suksesit	21
VIII.	Hapat e mëtutjeshëm	23
IX.	Përfundim.....	27

II. Përmbledhja e Përgjithshme

Programi për qytetarin aktive “Active Citizens” - është trajnim i ndërtuar mbi përvojën, njohuritë dhe ekspertizën pesë vjeçare të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale. Gjatë kësaj periudhe Instituti Kosovarë për Qeverisje Lokale ka zbatuar me sukses projekte të natyrës vlerësuese, hulumtuese dhe trajnuese. Konkretisht si pikë reference Instituti Kosovarë për Qeverisje Lokale ka pasur dhe do të ketë në njërën anë rolin e mekanizmave institucional në ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër kapacitetet monitoruese dhe qytetare në konsolidimin e demokracisë përmes pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje. Instituti Kosovarë për Qeverisje Lokale përmes fuqizimit të rolit qytetar kërkon shtigje në të cilat mund të intervenohet nëpërmes iniciativave që forcojnë mekanizmat e shoqërisë për aktivizim qytetar dhe në ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave. Nga sa u tha “Active Citizens” nëpërmes moduleve trajnuese të cilat janë ofruar gradualisht ka ndihmuar duke ofruar ligjërata, diskutime, punë në grupe dhe platformë për shkëmbim të përvojave dhe informacionit. Fillimisht “Active Citizens” është fokusuar në elaborimin dhe kristalizimin e konceptit modern qytetarisë aktive në Evropë dhe rajon. Programi “Active Citizens” përmes shkëmbimit të përvojave ka ofruar mundësi krahasimi mes modeleve të ndryshme të aktivizimit qytetarë nga demokracitë e konsoliduara dhe atyre në rajon. Në këtë mënyrë trajnimi ka kontribuar në elaborimin dhe analizimin e attributeve dhe karakteristikave të modeleve tjera të cilat do të mund të shfrytëzoheshin dhe akomodoheshin në modelin e vendit tonë. Programi për qytetari aktive në procesin e ofrimit të moduleve është përqendruar në ofrimin e materialit mbi apskte të demokratizimit, përfshirjes dhe kohezionit social. Në esence kjo përshkon qeverisjen nëpërmes informimit, konsultimit, pjesëmarrjes të qytetarëve dhe akterëve tjerë si pjesë e qytetarisë aktive. Në këtë aspekt programi drejtpërsëdrejti ose indirekt ka ndikuar në konsolidimin demokratik, por edhe në forcimin e lidhjes mes strukturave të zgjedhura/qeverisëse dhe të përfaqësuarve/ qytetarëve. Në qeverisje demokratike parashih praktika dhe procese të cilat sigurojnë që strukturat qeveritare nuk shpëputen nga vullneti, shqetësimet dhe pritjet qytetare. Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale me qëllim të forcimit të bashkëpunimit dhe rrjetëzimit, si dhe vëzhgimin e drejtpërdrejt në fushën e qytetarisë aktive ka ndihmuar sado pak në

ngritjen e vetëdijes qytetare për të kontribuar në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në përmirësimin e cilësisë së jetesës duke qenë vetë qytetarët akter.

Konkretisht dhe në veçanti programi “Active Citizens” është dizajnuar nga profesionist të fushës, dhe personalitete me eksperience. Si i tillë ky program ka trajtuar tema që në thelb shtrajnë nevojën për intervenim dhe përmirësim të gjendjes nëpërmes aktivizimit qytetarë. Më saktësisht, jeta e përditshme dhe zhvillimet në Kosovë janë prekur shumë nga zhvillimet bazë të tilla si informacion publik, pjesëmarrja në politikë dhe zhvillimi institucional, vullnetarizmi, avokimi, lobimit, fuqizimin gjinor, përfshirjen sociale, drejtësisë sociale apo arsimit. Programi “Active Citizens” është një program fleksibil por në rritje e sipër. Në një të ardhme programi ka për qëllim të mbulojë të gjitha komunat e Kosovës, por fillimisht programi ka përzgjedhur 5 Komuna, 30 Pjesëmarrës të ndarë në dy grupe – Grupi I, Grupi II. 40% prej pjesëmarrësve janë femra. Qytetaria aktive është një koncept i ri në Kosovë, andaj ingranimi dhe shfrytëzimi është nevojë për kohë në mënyrë që të marrë formë të konsoliduar. Gjatë këtij projekti, koncepti qytetaria aktive u përpunua në mënyrë të qartë gjatë tre module trajnimit, këto module treguan për rolin që luan e qytetaria aktive kulturën politike në pjesë të ndryshme të botës. Me fjalë të tjera, projekti i qytetarisë aktive elaboroi konceptin e qytetarisë aktive dhe praktikave që lidhen me këtë koncept në vendet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara në Evropë dhe më gjerë. Në këtë kontekst, trajnimi i ofruar nga grupit të parë të qytetarisë aktive ku ndër tjera u diskutua për zbatimin praktikave që mund të përdoren nga / individ apo ekipe punuese. Në mesin e këtyre praktikave ishin: pema e pritjeve, identiteti individual dhe në grup; ndërtimin e ekipit, duke praktikuar dialogun, zgjidhja e konflikteve, ndërmjetësimin dhe aftësitë e negociimit, shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave, menaxhimi i projektit, komunikim publik dhe avokim. Vlera e shtuar e grupit ishte krijimi i rrjetit social ndërmjet pjesëmarrësve nga gjashtë komuna. Përshtypja e përgjithshme nga projekti qytetaria aktive ishte shumë pozitive. Bazuar në mësimet e nxjerra nga projekti, dhe më e rëndësishmja duke iu përgjigjur nevojave kontekstuale, organizata zbatuese – Instituti Kosovare për Qeverisje Lokale (KLGJ) - pas konsultimit të ngushtë me Këshillin Britanik në Kosovës konsideruan se koncepti i qytetarisë aktive dhe praktika duhet të ndërliken me zhvillimet e qeverisjes lokale

andaj mësimet e marra nga praktika, njohurit e sjella nga vizita studimore në Angli u kombinuan dhe me praktikat e nivelit lokale apo njësisë themelore qeverisë

III. Prezantimi i Moduleve

Programi për qytetari aktive i njohur si “aktiv citizens” është zhvilluar në tri module bazike me nga tri ditë ligjërata në dy grupe të ndara. Trajnimet janë mbajtur në ambientet e Këshillit Britanik ku stafi i tyre ka



ofruar komoditetin e nevojshëm për punë. Metodologjia e punës është bazuar në udhëzuesin e Këshillit Britanik për qytetarin aktive, në përvojën e ligjëruesve dhe në formë të hapur dhe dialogimit me pjesëmarrësit. Modulet e trajnimit kanë qenë



praktike dhe të kuptueshme për vijuesit e programi ato përcilleshin me mjete konkretizuese, dhe me shembuj të nevojshëm. Fillimisht pjesëmarrësit janë njohur në mes vete, pastaj është prezantuar programi i Këshillit Britanik për qytetarin aktive dhe janë vendosur

rregullat e përgjithshme të trajnimit për vijues me qëllim të realizimit në bazë të udhëzuesit dhe projektit për qytetari aktive. Pastaj trajnerët e programit prezantuan vizionin e programit “Active Citizens”, çka dëshirohet të arrihet përmes këtij programi edukativ dhe cilat janë objektivat kyçe për fuqizimin e rolit të qytetarisë aktive.



Gjithashtu në prezantimin e programit u fol dhe për rolin e rendit të ri global, ngritjen e vetëdijes qytetare lidhur me rolin që ata kanë, po ashtu u prezantua shtytja që dëshiron ky program ti bëjë ngritjes së bashkëpunimit dhe besimit duke vepruar në

mënyrë pozitive si shoqëri për të ardhme më të mirë. Pjesëmarrësve gjithashtu ju shpjegua rëndësia e qytetarisë aktive, roli në shoqëri dhe kontributi që ai duhet ta japë për të mirën e përgjithshme. Pas prezantimit të programit dhe ndërtimit të konceptit nga pjesëmarrësit për programin, atëherë filloj trajtimi i temave të rëndësishme që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve për qytetarët aktiv. Temat që u trajtuan pasaj ishin:

Qasja në pjesëmarrjen politike nëpërmes kësaj teme u trajtua roli i shoqërisë në aspektin bazë demokratik të një shoqërie pjesëmarrjen në jetën politike. Përmes kësaj synohet të shpjegohet roli i qytetarëve aktiv në zhvillimin e politikave që ndërmerren në lokalitete ku ata jetojnë dhe më gjerë.

Ndërtimi i besimit dhe të kuptuarit: promovimin e dialogut, u shpjeguar për rolin që ka qytetaria aktive në promovimin e dialogut dhe besimit, përmes së cilës mëtohet të arrihet në ndërtimin e vlerave universale sa i përket diversitetit kulturor, etnik, racor etj.

Kultura dhe identiteti, gjatë trajnimeve ligjëruesit prezantuan rolin që ka diversiteti kulturor dhe identiteti, po ashtu pas prezantimit pjesëmarrësit u ndanë në grupe dhe prezantuan rolin që ka diversiteti kulturorë dhe identiteti në një shoqëri të hapur.

Ligjëruesit pasi që shpjeguan konceptet bazë të qytetarisë aktive, duke përfshirë, dialogun , qasjen në pjesëmarrjen politike, kulturën dhe identitetin dhe tema tjera që kanë të bëjnë me ngritjen e

kohezionit social dhe përkrahjes së grupeve të marxhinalizuara, rendësin e qytetarisë aktive në përkrahjen dhe promovimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore në mënyrë të barabartë. Pas kësaj pjesëmarrësit mësuan



praktika për menaxhimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të tyre përmes përpilimit të projekt propozimeve, planifikimit, ngritjes së fondeve dhe më e rëndësishmja ndërtimin e vizionit.

Vizioni, Ligjëruesit u ndalën dhe vunë theks të veçantë në ndërtimin e vizionit si mekanizëm i adekuat që drejton në sukses duke qenë afatgjatë, i vlefshëm, i arritshëm, dhe i ndarë në shumë njerëz. Po ashtu u prezantuan dhe dallimet në mes të menaxherit dhe udhëheqësit e që pikërisht ky dallim vjen në bazë të vizionit. Pjesëmarrësit pas prezantimit u ndanë ku u caktuan tema për krijimin e vizionit të komunitetit për problemet që i preokupojnë ata.

Prezantimi publik dhe avokimi, projekti për qytetari aktive përpos ngritjes së kapaciteteve të rinjve synim tjetër ka pasur krijimin e rrjetit të rinjve që janë përfaqësues të mirë publik të punëve dhe angazhimeve që bëjnë për këtë arsye trajtim të veçantë i është dhënë prezantimit publik, ndërtimit të marrëdhënieve të mira me publikun, komunikimin efikas, dhe ndërtimin e qartë të platformës për komunikim.

Çështjet që trajton qytetaria aktive kërkojnë qasje të veçanta për arritjen e objektivave, andaj trajnimi për avokim ka qenë i përpiluar në atë mënyrë që tu a bëjë sa më të qartë pjesëmarrësve rendësin që ka argumentimi dhe gjetja e rrugëve të duhura për të shtyre çështjet që janë me interes për shoqërinë.

Ngritja e fondeve dhe menaxhimit i projekteve, trajnerët shpjeguan para pjesëmarrësve rendësin që ka ngritja e fondeve në realizimin e objektivave qofshin ato individuale apo ekipore në qytetari aktive. Ngritja e fondeve kërkon shkathtësi dhe planifikim të qartë për të bindur qoftë donatorët apo komunitetin për përkrahjen e synimeve tuaja. Ndërkaq shkrimi dhe menaxhimi i projekteve, kërkon vizion dhe planifikim të qartë që përmes aktiviteteve të arrihen objektivat që duhet të jenë specifike dhe të matshme.

Pra siç u prezantua në vija të trasha forma a ligjërimit, temat e trajtuara, metodologjia e punës, ndërveprimi në mes ligjërimit dhe bashkëbisedimit shihet qartë Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale në realizimin e projektit “Active Citizens” përmes moduleve ka arritur:

Programi “Active Citizens” ka arritur të krijoj një iniciativ të rinjsh që përmes angazhimit në shoqërinë civile dëshirojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ngritjen dhe fuqizimin e demokracisë dhe zhvillimin e saj . Si grup “Active Citizens”ka krijuar diversitet në ide dhe mendime , niveli i analizës dhe debatit ka qenë parim themelor në vënien e prioriteteve dhe temave që janë trajtuar.

Programi “Active Citizens” ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e rolit të shoqërisë në vendim-marrje përmes mbikëqyrjes së institucioneve, si mekanizëm që ndikon drejtpërsëdrejti në performac më të mirë ,pra impakti që jep një shoqëri demokratike përmes pjesëmarrjes dhe kontrollit qon në ngritje të transparencës dhe llogaridhënies parime këto bazë për qeverisje të mirë.

Programi “Active Citizens” ka promovuar ngritjen e kulturës politike në vend si mekanizëm i rëndësishëm dhe domethënës në zhvillimin e vendit , duke bërë pjesë të gjithë akterët në hartimin e politikave, përfshirja më e gjerë e tyre duke përfshirë profesionist të fushave, shoqërinë civile dhe qytetarët që drejtpërsëdrejti preken nga politik bërja, kjo qon deri tek hartimi i politikave të një dimenzioni të ri dhe vizion më të qartë për objektivat që synohen të arrihen , andaj ne synojmë që të shërbejmë si

mekanizëm që sjell akterët e rëndësishëm vendim-marrës më afër profesionistëve dhe atyre që preken nga politikat.

Programi “Active Citizens” synim ka pas fuqizimin e femrës dhe të rinjve në



vendim-marrje, duke i parë akter të fuqishëm dhe potencial në proceset që dalin si sfida përball rrugës që jemi nisur asaj të integritit evropian. Promovimi i përfshirjes sa më të gjerë të pjesëmarrjes në vendim-marrje , ndihmon në forcimin e besimit politik

në institucione duke u ndjerë pjesë e krijimit të politikave dhe zhvillimit të tyre .

Programi “Active Citizens” ka inkurajuar zhvillimin e politikave të reja , duke sjellë modele të ndryshme nga vendet rajonit dhe nga vizita studimore në Angli duke i harmonizuar me rrethanat e vendit . Krijimi i politikave të reja përmes aktivizmit qytetarë ndikon drejtpërsëdrejti në ofrimin e alternativave që promovojnë ngritjen e vetëdijes qytetare për rolin e tyre që kanë në zhvillimin e demokracisë. Tejet e rëndësishme ka qenë fuqizimi i sa më tepër mekanizmave dhe akterëve në hartimin dhe planifikimin e politikave publike me pjesmarrje në vendim-marrje.

IV. Vizita studimore në Bradford të Anglisë

Pas trajnimit në tri module lidhur me qytetarinë aktive dhe pas një performancë të mire treguar nga grupet nga komunat e Prishtinës, Gjakovës, Podujevës, Gjilanit, Kamenicës u zgjedh një grup që do të bënin një vizite studimore shtatë ditore në Angli.

Në Angli pjesëmarrës përpos grupit nga Kosova ishin edhe dy grupe tjera njeri grup nga Maqedonia dhe tjetri nga



Armenia. Agjenda e shtatë ditëve të vizitës ishte mjaft e ngjeshur me aktivitete dhe

vizita. Pjesëmarrësit u vendosën në Bradford, qytet afër Manchester-it, një qytet me divergjenca kulturore në mes të banoreve të tij. Pjesëmarrësit nga Kosova vizituan institucione të rëndësishme në Bradford, ata takuan kryetaren e Bradfordit (Lord mayor)



Naveeda Ikram e cila shquhej si femra e pare myslimane e zgjedhur për kryetare. Gjithashtu ata vizituan institucionet shkollore dhe punën që bëhet aty, vizituan muzeume dhe parqet në Bradford. Grupi nga Kosova gjatë vizitës kishin udhëheqës (guide) një grup në Angli ku ata shpjegonin agjendën. Pjesëmarrësit gjatë vizitës u takuan me profesor dhe student të Universitetit të Bradfordit ku u njohën me kushtet dhe metodën e punës së tyre, po ashtu ata krahasuan dhe diskutuan lidhur me

ngjashmëritë dhe dallimet në mes vendeve. Stafi akademik dhe administrativ i këtij Universiteti i njoftoi pjesëmarrësit në lidhje me programet akademike, përmbajtjen e tyre, numrin e studentëve si dhe formën e funksionimit. Si përfundim nga ky takim u konstatua se një universitet bashkëkohor sikurse universiteti në fjalë ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal, në thellimin integrimin shkencor dhe kulturor mes qytetarëve, dhe gjithashtu ndikon në thyerjen e barrierave. Grupi i qytetarisë aktive gjithashtu u njoh me punën që benë Këshilli i Qytetit (Kuvendi Komunal) dhe mënyrën se si janë të organizuar dhe si zgjidhen. Gjithashtu u pa nga afër rezultatet e socializmit të grupeve të marginalizuara dhe trajtimi i tyre, ata panë se si të rinjtë me të ngecur në zhvillim punonin dhe në njëfarë mënyrë përpos që ndihmoheshin në pavarësimin e tyre financiar ndihmonin edhe socializmin e tyre në një raport tjetër, jo në ata të ‘kërkim ndihmës’ por socializmit me baze punën që bënin sikur të gjithë punëtorët tjerë. E veçanta e këtij takimi ishte dhe dreka e përbashkët ku u pa angazhimi e këtyre të rinjve dhe puna që aq me zell ata punonin. Vizita në museum i trenave të vjetër që ishin mbledhur edhe nga shtetet tjera i kishte përgatitur për prezantim. Brenda tyre shfaqeshin dokumentare lidhur me historinë e trenit si makine dhe shpikjen e tij. Vizita e grupit nga Kosova nuk kaloi pa prezantim në mediat e qytetit ku atje u shkrua edhe në shtypin dhe portalet e qytetit. Përpos agjendës së aktiviteteve informuese dhe edukative pjesëmarrësit kishin dhe aktivitete rekreative. Ata sprovuan vetën në gara të ndryshme. Pjesëmarrësit nga vizita studimore në Angli shkëmbyen praktika të aktivimit qytetarë dhe mësuam shumë gjëra nga njeri tjetri, nga përvojat e njeri tjetrit nëpër shtete të ndryshme, lloje të kulturave dhe zakoneve e megjithatë ata theksojnë se komunikimi mbetet universal mes njerëzve. Pjesëmarrësit nga Kosova shpjeguan shumë shpesh rreth Kosovës si shteti më i ri sidomos për grupin e Armenisë edhe në aspektin gjeografik por edhe në atë politik të krijimit të shtetit. Pjesëmarrësit u ndanë mjaft të kënaqur me vizitën dhe ata theksuan se: e rëndësishme është se krijuam shokë që bëjnë aktivitete të ngjashme në shtete të ndryshme, krijuam miqësi dhe shkëmbyem përvoja. Komunikimi vazhdon dhe më tutje për të ndarë përvojat dhe punën që bëhet në mes vendeve.

V. Roli i nismave qytetare, OJQ-ve dhe Shoqatave në ngritjen e Qytetarisë Aktive: Rasti i Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë

Në këtë drejtim, vazhdimi i projektit të qytetarisë aktive nga Instituti Kosovarë për Qeverisje Lokale u zhvillua me një trajnim tre ditësh për qeverisjen lokale. Qëllimi i këtij trajnimi ishte i fokusuar në

edukimin e pjesëmarrësve në çështjet që lidhen me qeverisjen lokale, si dhe zhvillimet bazë. Rezultati dhe ndikimi nga ky trajnim është refleksion i nevojave të komunitetit. Në këtë drejtim, është e zakonshme që strukturat institucionale më të afërta në këtë rast



niveli lokal është më pran kërkesave dhe nevojave të qytetarëve sesa strukturat qendrore, dhe në Kosovë strukturat themelore janë komunat. Konkretisht trajnimi i dytë nxorri në pah rolin që ka niveli lokal në qeverisje dhe në raport me qytetarin duke pas parasysh rolin që luajnë, si dhe shërbimet që ata japin. Në mënyrë që të sigurojë një trajnim të plotë nëpërmjet tri ligjëratave dhe prezantimeve të ofruara nga ekspertë të fushës, Instituti Kosovarë për Qeverisje Lokale reflektoj në përbërjen dhe mekanizmat institucionale që përbëjnë komunat, përkatësisht bazën e tyre ligjore dhe formale. Për më tepër u trajtuar aspekti i kompetencave komunale . Duhet theksuar rëndësinë që ka relacioni në mes ofrimit të shërbimeve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në politikat institucionale, si dhe zhvillimet publike. Pas këtij sesi fillestar, përmes i fokus grupeve të punës, pjesëmarrëseve i'u kërkua që të përgatisë një listë të gjerë të çështjeve problemore për lokalitetet e tyre përkatëse, dhe komunitetin ku jetojnë. Kjo listë synonte një bazë për iniciativat e ardhshme qytetarëve aktiv potencial si dhe për analizën dhe krahasimin e situatave dhe ambienteve të ndryshme duke marrë parasysh kur të angazhohen në emër të komunitetit. Në mënyrë që të japin shembuj praktikë

dhe modele tre OJQ përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova ndanë përvojat e tyre individuale dhe organizimin e qytetarisë aktive.

Përvoja e lëvizjes "Mjaft" nga Shqipëria, përfaqësuesit e saj treguan se ka disa elemente kyçe që mund të shërbejnë si instrumente dhe udhëzues drejt suksesit. Në mënyrë që të gjenerojnë rezultate dhe ndikim në lokalitetet e tyre / komuniteteve shembujt treguan se si lëvizja MJAFT duhet të përqafojë dhe të zbatojë praktikat



alternative dhe inovative të komunikimit.

Në rastin e MJAFT, këto praktika varionin nga të ashtuquajturat praktikat e 'rrugës' teatrit të protestave. Megjithatë, sipas përfaqësuesit të kësaj OJQ-je ka raste kur përveç kritikës

publike dhe avokimit njerëzit presin nga ju dhe përfshirja në organizimin për të dalë me zgjidhje alternative për sfida të caktuara ose probleme. Në këtë rast qytetarët aktivë duhet të përfshihen në mbledhjen e dëshmive dhe përgatitjen e propozimeve alternative ndaj politikës që është duke u kritikuar. Për më tepër, ka një element shtesë për sukses, dhe kjo është rëndësia e paanshmërisë politike. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të bëhet një lëvizje e vërtetë apo iniciativë e cila vërtet mbron interesat e komunitetit, nuk duhet të marrë në konsideratë atë që është peizazhi politik dhe cilët janë lojtarët politike. Kjo do të thotë që një iniciativë apo lëvizje të mirëfilltë nuk do të kursejë nga partitë politike, liderët kritika apo zyrtarëve si në qeveri apo në opozitë. Kjo do të thotë se duhet të jenë të shqetësuar rreth fakteve dhe zhvillimeve reale dhe as për agjendat politike as liderët politikë. Organizata Mjaft ka shpjeguar se është e rëndësishme që një organizatë e ndërton marrëdhënie të ngushta me mediat dhe gazetarët, dhe kjo nuk është e mundur pa komunikim të drejtpërdrejtë me këta njerëz. Sipas Mjaft atë nuk është e mjaftueshme që të përdorin mënyra standarde e komunikimit të tilla si dërgimin deklaratë për shtyp, duke organizuar një konferencë

ose dërgimin gjetjet. Ndonjëherë dikush duhet të jenë të reja dhe për të tërhequr vëmendjen e publikut dhe të medias. Në përvojën MJAFT-së kjo do të thotë që njerëzit brenda një iniciativë apo organizatë duhet për të kryer veten në publik. Në disa raste rasti i tregon Mjaft përfshijë artit dhe teatrit në kritika publike apo avokimit mund të ndihmojë rastin tuaj, mund të mobilizojë mbështetjen publike apo edhe mund të shërbejë si një mjet për presion ndaj atyre që nuk kanë tendencë të konsultohen ose përfshijë publikun dhe qytetarët. Megjithatë varësisht nga situata dhe konteksti një ka për të ndërtuar plane veprimi se si për të sfiduar zhvillimet negative. Në të njëjtat linja, përfaqësues i OJQ INPO nga Kosova ka argumentuar se ai dhe kolegët e tij aktual nga organizata e tij ishin shumë entuziaste përmirësimin institucional dhe zhvillimet politike. Në disa raste ata kanë protestuar kundër mungesës së sigurisë në komunikacion, kundër korrupsionit, si dhe zhvillimet e tjera negative.



Organizata INPO shpesh përdorë rezultatet e hulumtimit të ngushtë / kujdesshëm vëzhgimin e praktikave institucionale të këqija, në mënyrë që të marrë një nismë për ndryshim. Në disa raste kjo do të përfshijë përdorimin e medias si një mjet për komunikim me

publikun e gjerë dhe të zyrtarëve në

mënyrë që të gjenerojnë vrullin e nevojshme për ndryshim. Në raste të tjera ata do të protestojnë apo të bëjnë punën publike duke përdorur artet apo forma të tjera të

komunikimit, dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme ata do të organizojë konferencë dhe debatet mbi temat të veçanta. Përvoja e INPO tregon mënyrën se si të bëhem, organizime dhe të ketë nisma të suksesshme, si të mbahet ndjenja e vullnetarizmit apo entuziazmit me fonde minimale. Kjo do të thotë fillimisht rregulli është se ka një nevojë për vullnet të mirë nga ata që propozojnë dhe të përgatisë një iniciativë, të paktën në fillim ka një nevojë për të vullnetarizmit në mesin e njerëzve. Pastaj koha mund të vijë kur fondet janë të nevojshme dhe për këtë qëllim duhet të ketë planifikim adekuat, rrjeteve dhe avokimi.

Tri ditë trajnimi janë dhënë edhe shembuj nga Komuna e Novobërdë. Kryetari i kësaj komune prezantoi situatën dhe

kontekstin e vërtetë se si zhvillimet lokale në institucionin e tij të marrin formë. Nga përvoja e tij në mënyrë që të tërheqë vëmendjen dhe për të gjeneruar një ndikim të drejtpërdrejt ka komunikuar me zyrtarët dhe udhëheqësve politikë. Nëse ka një



organizatë të shoqërisë civile apo OJQ që kërkon komunën për të dhënë apo të marrë një iniciativë që është gjithmonë më e lehtë në qoftë se ju direkt adresoni këtë çështje për ata që vendosin të cilët janë kompetent dhe kanë kapacitete për ta bërë këtë. Në këtë drejtim, komunikimi me zyrtarët dhe udhëheqësve politikë rrit probabilitetin për suksesin e atyre që presin nga institucioni. Në disa raste kjo rritë interesimin në zhvillimet e përditshme brenda institucioneve, në raste të tjera kjo mund të kërkojë nga ju që të ketë më shumë informacion dhe për të ditur sfondin e zhvillimit të politikave, dhe në fund kjo mund të kërkojë që ju të keni, vëmendjen e fokusuar dhe rrjetin. Krejt këto janë parakushte për këdo që dëshiron të përfshihet në çështjet institucionale dhe të komunitetit. Për këtë qëllim ka edhe praktikatat dhe mekanizmat që mundësojnë qytetarët të ndikojnë në punën e institucioneve. Për shembull ka debate publike, komitetet konsultative apo takime direkte mes qytetarëve dhe zyrtarëve.

Ndonjëherë radiot dhe televizionet lokale mund të përdoren për të nxitur agjendën tuaj. Nga përvoja e kryetarit është gjithmonë produktive të angazhoheni, dhe kjo shpesh kërkon përgjegjësi civile dhe institucionale nga zyrtarët si dhe qytetarët. Në instancën e fundit kjo është përgjegjësi për përfaqësuesit institucionalë të cilët janë të përgjegjshëm për qytetarët dhe jo anasjelltas.

Përveç kësaj KLGJ krijoj grupe pune për të adresuar disa çështje të rëndësishme. Temat ishin: roli i institucioneve dhe donatorëve ndërkombëtarë, roli i OJQ-ve, kapacitetet dhe mundësitë e tyre, si dhe identifikimin e zonave për ndërhyrje nga qytetarët aktivë. Përveç kësaj, të gjithë pjesëmarrëseve u kërkua që të japin listën e tyre të zonave ku ata shohin mundësinë për ndërhyrje me anë të qytetarisë aktive, dhe shkonin nga lista luftimin e dhunës në shkolla për të zgjeruar mbështetjen për arsim në mesin e studentëve të talentuar. Me pak fjalë, tre ditë ofruan ngritjen e kapaciteteve për të rinjtë, rritja e vetëdijes dhe entuziazmin gjeneruar për aktivizëm qytetarë, po ashtu u hulumtuan edhe fushat për ndërhyrje në të ardhmen. Gjithashtu përvojat nga vende të ndryshme kanë ndihmuar pjesëmarrësit të njohin rëndësinë e situatave specifike dhe konteksteve. Së fundi trajnimi gjithashtu ka zgjeruar dhe forcuar rrjetin e qytetarëve aktivë.

VI. Përshtypjet e pjesëmarrësve

Albulena Biba

“Aktivitetet e përbashkëta, diskutimet, debatet, si dhe shkëmbimi i përvojave të ndryshme mes pjesëmarrësve për ne kanë qenë shumë të rëndësishme dhe kanë mundësuar në një formë aktivizimin për qytetari aktive dhe në një të ardhme të afërt inkuadrim në strukturat vendimmarrëse.”

Armend Bajgora

“Programi “Qytetari Aktive” ka sjellë formësim dhe plotësim në personalitetin tim me trajnimet e aplikuara gjatë moduleve të ndryshme prandaj jam i lumtur që ky program do të vazhdoj përsëri dhe presim që programe dhe trajnime të tilla të shfaqen edhe në të ardhmen, duke na ofruar mundësi të njihemi me gjera të reja për të cilat ende janë të panjohura për ne.”

Dafina Dobërdoli

“Trajnimi profesional në lidhje me shkruarjen e projekteve menagjimin e tyre dhe gjetjen e donacioneve i cili ka shërbyer dhe do të shërbejë në të ardhmen si baze e mire për aktivitetet e programit. Si të jemi qytetare aktiv dhe si do të ndikoj qytetaria aktive në të ardhmen në komunitetin në të cilin jetojmë”

Dafina Dula

“Trajnim i dobishëm dhe me kualitet për mënyrën e qarte të qytetarise aktive, teknika dhe metoda të rëndësishme. Të kuptuarit e një rëndësie dhe vlere të një qytetari dhe përgatitja e të qenurit një qytetar aktiv, me vlere dhe i përgjegjshëm për qytetarinë.”

Dukagjin Leka

“Programi i British Council për Qytetari Aktive ka qenë një program mjaft i qëlluar për ne. Une përveç që isha pjesë e programit në Kosovë, kisha nderin të jem edhe pjesëmarrës në trajnimin që u organizua në Bradford të Britanisë së Madhe. Unë personalisht kam mësuar shumë nga udhëheqësit e projektit dhe në të njëjtën kohë kam mësuar shumë nga pjesëmarrësit e tjerë në projekt. Ka qenë shumë e mirëseardhur për mua vizita në Bradford, ku për së afërmi kam parë se si mund të ndryshohen gjërat në mënyrë pozitive për komunitetin, kuptohet nëse punohet në mënyrë aktive dhe mendohet në mënyrë pozitive.”

Faton Podvorica

“Perfitimet nga programi per qytetari aktive gjithsesi se jane te medha dhe kane sherbyer shume edhe ne aktivitetet pasuese. Menyra e qasjes ne modelin ‘qytetari aktive’ eshte shtjelluar dhe studiuar mire ne kete program dhe shume nga ato metoda dhe ide besoj qe i kam perdorur edhe ne aktivitetet qe kam zhvilluar me pas.”

Fleta Baraku

“Programi për qytetari aktive në radhë të parë më ka ndihmuar për reflektim mbi vlerat e mia dhe arritjen e qëllimeve në këtë fushë të veprimit. Gjithashtu ky projekt më ka insuruar dhe motivuar për të punuar në fushën e qytetaris aktive. Konkretisht nga ky program kam fituar shumë njohuri dhe ide për qytetarin aktive ku sot unë bashkë me tri mike të mija kemi hapur organizatën jo qeveritare ku njërin ndër qëllimet kryesore kemi promovimin e qytetaris aktive në Kosove si element shumë të rëndësishem në zhvillimin e jetës sociale në koherencë me shtetet perendimore.”

Granit Thaçi

“Besoj qe me ndjekjen e programit per qytetari aktive edhe deri me tash kam mësuar shumë si dhe kam përdorur këto mësimet edhe ne shume nga aktivitetet e organizuara. Nga ky program gjithashtu kam qene pjesëmarrës ne një vizite studimore ne Angli për shtate dite.”

Jonila Fetija

“Kjo mua më ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive, në përmirësimin e aftësive menagjoriale dhe udhëheqëse. Rol tjetër të rëndësishëm në mua ka pasur në trajnimin për ndarjen e ideve, mbështetjes, informatave dhe këshillave. Thjeshtë, më ka mësuar të jem një qytetare aktive në komunitetin tim.”

Lavdie Zymeri

“Nga programi Qytetarët Aktiv kam mësuar për mënyrat si qytetarët mund të ndikojnë në jetën e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme. Përmirësimi i jetës së qytetarëve varet shumë edhe nga mënyra si ata veprojnë në mjedisin e tyre; sa ata kujdesen për qytetin e tyre dhe si e perceptojnë vendin ku jetojnë.”

Lavdim Klaiqi

“Nga sesionet e trajnimeve kemi përfituar njohuri të reja në fushën e qytetarisë aktive dhe se këto njohuri dhe përvoja janë praktikuar edhe në jetën reale. E kam konsideruar të rëndësishme pjesë të caktuara të sesioneve rreth lidershipit si një moment të rëndësishëm të punës sonë të përditshme. Disa nga këto veti të mësuara më kanë ndihmu shumë në raport me punën ekipore si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.”

Marigona Peni

“Përfitime e shumta që kam marr nga Active Citizens pikë se pari është që kam pasur mundësinë të njoftohem me disa njerëz shumë të mirë dhe shumë të embel ku disa kanë pasë disa mendime shumë të ndryshme nga unë e disa të tjera shumë të ngjashme. Gjithashtu kemi mesuar si t’i ndimojmë komunitetin tonë me atë pak mundësi që secili prej nesh ka.”

Nëntor Korça

“Përfitimet për mua si pjesëmarrës kanë qenë shumë të kënaqshme. Kam pasur mundësinë të njihem me njerëz të rinj nga qytete të ndryshme, të shoh përvojat dhe kualifikimet e tyre. Kam përfituar gjithashtu dhe nga trajnimet dhe ligjëratat që kemi zhvilluar, të cilat më kanë aftësuar në sferat përkatëse. Ka qenë një përvojë shumë e mirë e cila sigurisht më ka ndihmuar shumë.”

Pajtim Balaj

“Programi për Qytetari Aktive ishte një program mjaft i pasur, i cili ka më ka ndihmuar shumë në realizimin e projekteve të cilat pasuan pas përfundimit të këtij programi dhe projektet të cilat ne do të mund të realizojmë në të ardhmen. Kemi mësuar një mënyrë të re të shkrimit të Projekt Propozimeve dhe rreth mënyrës së ngritjes së fondeve. Mbi të gjitha nga ky program ne i kemi zgjeruar njohuritë tona për atë se si mund të kontribuojmë shoqërisë ku ne jetojmë duke qenë qytetar aktiv.”

Ramadan Mramori

“Përfitimet që unë pres nga ky program është që të mësoj mënyrën më të lehtë për të bërë ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësi të mia në komunitet. Këto përgjegjësi janë: Sociale dhe Morale, Pjesëmarrja në Aktivitetet e Komunitetit dhe Dija Politike. Aftësimi për qytetari aktive është i rëndësishëm sepse ndihmon në avancimin individual dhe shoqëror në kërkim dhe mbrojtje të vlerave të demokracisë.”

Rina Nixha

“Vete pjesmarrja ne programin Qytetari Aktive ka qene fitimprurese ne aspektin e perfitimit te njohurive qe kemi marre nga nje grup ligjeruesish profesionist, njerezit qe kemi njohur dhe lidhja qe kemi fituar mes nesh gjate programit. Nga ana profesionale konsideroj qe plusi me i madh qe kam marr eshte krijimi dhe hartimi i projekteve qe kjo eshte nje lemi me te cilen qdo dite e me shume po perballemi dhe kemi nevojë per njohuri me te zgjeruara.”

Sunad Kurti

"Qytetarët aktiv" ishte një projekt shumë i dobishëm i cili na tregoi bazat e menaxhimit të projektit dhe organizimit .Projekti gjithashtu ishte një shans për të takuar njerëz të rinj si vetja që ndanë të njëjtin vullnet që të jenë aktiv dhe të punojnë në drejtim të përmirësimit vendit ku jetojn .Në të tardhmen unë pres që me të vërtetë të fillojnë të bëjnë diçka, që ne të fillojmë të vënë teorinë në praktikë dhe të fillojnë të qenit me të vërtetë një forum. Unë jam duke takuar njerëz të rinj dhe të shkëmbejnë ide së bashku.”

Tringa Lajqi

“Kjo ishte një eksperiencë që më ndihmoi të reflektoja më shumë në rëndësinë e të qenit një qytetar aktiv që mundohet të ndryshojë diçka në vendin e tij dhe pikërisht ky ndryshim fillon prej nesh. Mësova më shumë për kulturat tjera si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit në grup.Ndër gjërat më të rëndësishme që kam përfituar është avancimi në hartimin e projekteve dhe metodave që duhet ndjekur për të realizuar një projekt.”

Veton Krelani

“Nga programi kam fituar njohuri të shumta mbi atë se si mund të kontribuoj në komunitetin tim. Njohja me metodat e ndryshme të përpilimit të projekteve dhe arritjes së realizimit të tyre më ka shërbyer shumë dhe do të më shërbejë edhe në të ardhmen. Takimi me njerëz të rinj dhe fitimi i përvojave të reja ishte poashtu diçka shumë e veçantë. Por mbi të gjitha kam mësuar që jemi ne ata që mund të bëjmë ndryshime në vendin dhe hapësirën që jetojmë.”

Yll Muriqi

“Përfitimi që unë pres nga ky program është që të mësoj mënyrën më të lehtë për tu bërë pjesë aktivitetëve shoqërore. Aftësimi për qytetari aktive për mua është i rëndësishëm sepse më ndihmon në avancimin tim, ky avancim në njohuri më shërben mua që të jem aktiv në komunitet.”

VII. Storjet e suksesit

Granit Thaqi

Duke shprehur falënderimin dhe mirënjohjen time për ju dhe institutin (KLGJ) lidhur me programin “Active Citizen”.

Fillimisht modulet që kemi mbajtur në British Council e pastaj vizita studimore në Angli dhe tash në fund trajnimet e mbajtura në Durrës besoj se kanë ndikuar shumë tek unë dhe shpresoj edhe tek të gjithë pjesëtarët tjerë të këtij grupi.



Tash se voni kam filluar punën si koordinator i projektit në Lëvizjen FOL për Podujevë dhe ajo çka në të vërtet bëjmë në ka të bëjë me atë çka kemi mësuar dhe shtjelluar gjatë atyre moduleve të trajnimeve, që gjithsesi do të më hyjnë në punë jo vetëm tash por edhe gjatë punëve dhe aktiviteteve tjera që do të bëjë¹.

Shpesh herë individ të forte nuk arrijnë të krijojnë një grup të fortë, e në këtë rast shpresoj dhe besoj se kemi krijuar një grup të fortë.


**Faleminderit,
Graniti**



¹ <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/53559/fol-komunat-qe-s-i-japin-llogari-publikut/>

Ramadan Mramori & Yll Muriqi

Duke falënderuar Institutin Kosovare për Qeverisje Lokale po ashtu vlenë të theksohet gatishmëria e Drejtorit të KLG-së për bashkëpunim të vazhdueshëm me pjesëmarrësit edhe në aktivizimin e tyre të mëtutjeshëm, mua personalisht më ka ndihmuar shumë ky program, tani unë në bashkëpunim me disa koleg të fakultetit që ishim përfitues të këtij programi kemi themeluar një OJQ të quajtur Centre for Democracy and Development dhe qëllimi i themelimit të kësaj OJQ-je ishte që ne të vazhdojmë rrugën që kemi filluar në këtë program, përkrahja e stafit dhe drejtorit të KLGIsë për ne si një grup i të rinjve ka qenë shumë domethënëse për vazhdimin e punës tonë.



Duke u frymëzuar nga ky program unë dhe Yll Muriqi, një koleg i imi i fakultetit, kemi vazhduar të ndjekim programe të tilla edhe jashtë Kosovës, programi që kemi qenë ishte Preparing Global Leader Institution ku pjesëmarrës ishin të rinj nga vende të ndryshme të botës. KLGIsë ka qenë i hapur për ne edhe në programet e tjera të cilat i ka organizuar siç është Akademia për Qeverisje Lokale.



Unë dua të falënderoj KLGInë dhe gjithë stafin e saj për punën që bënë për vetëdijesimin e qytetarëve, për përmasimin e gjendjes së institucioneve lokale dhe mundësinë që më dha mua dhe kolegëve të mi për të qenë pjesë e programe të saj.

VIII. Hapat e mëtutjeshëm

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale gjatë realizimit të projektit “Aktive Citizens” ka identifikuar dhe partner tjerë aktivë në këtë fushë dhe ka ndihmuar në ngritjen dhe fuqizimin e tyre shkurtimisht po prezantojmë një iniciativë të rinjsh që merret me fuqizimin e rolit të rinis kjo organizatë ka rrjet të qëndrueshëm dhe aktiv të rinjve dhe se mendojmë se hapat në vijim të programit duhet të bashkërendohen me këtë organizatë.

Të bashkangjitur gjeni fushëveprimin e kësaj organizate dhe rolin e Institutit Kosovarë në ndihmën që i ka dhënë gjatë themelimit.

Alternativa për Fuqizimin e Rinisë së Kosovës për qëllim kryesor ka ngritjen dhe fuqizimin e rolit të rinisë në vendim-marrje, ky Institucion është themeluar me iniciativën e shumë institucioneve rinore nga nivelet lokale si: Qendra Rinore, Këshille të Veprimit Rinor Lokal, Organizata Joqeveritare, Grupe jo formale , Klube Rinore dhe individ të cilët dëshirojnë të japin kontribut në përparimin, fuqizimin dhe aktivizimin e te rinjve.

Në vazhden e takimeve informuese, grupi iniciues AFRK-s, duke pasur parasysh përvojën profesionale dhe performancën e shkëlqyeshme që ka Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale në krye me Drejtorin Ekzekutiv z. Besnik Tahiri, si me Institucionet Vendore dhe Ndërkombëtare në Kosovë, dhe përvojën e tyre të gjatë sidomos me qeveritë lokale prej nga edhe ishte baza e AFRK-s, ne i bëmë ftesë për një takim z. Tahiri, i cili e pranoi kërkesën tonë dhe bashkë me bashkëpunëtorin e tij z. Besnik Muçaj u takuan me anëtarët e AFRK-s .

Anëtarët e AFRK-s e njoftuan atë për arsyen e themelimit, rolin që ka dhe që mëton ta ketë në ndihmë të rinjve, përfaqësimin, organogramin, poashtu kërkuan nga z. Besnik Tahiri, që me përvojën dhe kontaktet që ka ta ndihmoj AFRK –n, dhe ndodhi ashtu ngase z.Tahiri dhe Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale ishte ndihmë dhe bazë themeluese e AFRK-së, sepse e vuri në dispozicion të gjithë potencialin e tij në ndihmë themelimit të AFRK-s, hartimit të dokumentacionit qeverisës, si dhe ndihmoj me kontakte dhe lobim nëpër institucionet lokale.

Ky institucion zyrtarisht është publikuar më 15 Shtator 2012, në Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë, në një Festival Rinor të organizuar nga GIZ-EDYK , i cili është mbajtur në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri ku ishin prezent mbi 1000 të rinj që janë aktiv në Organizata të ndryshme nga mbarë Kosova.

Pas publikimit është bërë ftesë publike për të gjitha Organizatat që t'i bashkohen AFRK-së duke vënë nënshkrimin e tyre në Deklaratën themeluese të AFRK-së.

Për momentin AFRK në strukturën e saj ka 31 institucione që burojnë nga Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (Qendra Rinore dhe KVRL) dhe dhjetëra OJQ dhe grupime tjera rinore që do të thotë se ky institucion ka shtrirje në shumicën e Komunave të Kosovës.

Institucionet anëtare të AFRK-së, të cilët vijnë nga e gjithë Kosova edhe më parë kanë realizuar edhe në të kaluarën aktivitete që direkt kanë nxitur qytetarinë aktive dhe aktivitetet e tyre janë shpërblyer jo vetëm me pjesëmarrjen e gjerë por edhe shpërblime të tjera. Në vazhdim po ua përmendim disa nga këto aktivitete :


Aktivitete gjatë kohës kur shumë komuna kishin shpallur gjendjen e Jashtëzakonshme për shkak të reshjeve të mëdha të borës, disa nga institucionet anëtarë kishin (KVRL-Podujevë, KVRL-Vushtrri, KVRL-Deçan, KVRL-Istog) kishin organizuar aksione për largimin e borës nëpër rrugët e qyteteve përkatëse, dhe këtyre aktiviteteve u janë bashkuar shumë qytetarë dhe përfaqësues institucionesh.



Organizmi i shume tryezave, debateve dhe aksioneve simbolike si : ecja në rrugë në shenjë proteste kundër parkimit të veturave në trotuar, proteste kundër huliganizmit, kampanja kundër përdorimit të armëve me sloganin “Festo me Zemër jo me Armë”



Institucionet anëtare të AFRK-së ishin bartëse dhe organizatore të “Let’s do It” nëpër shumë komuna të Kosovës dhe treguan sukses të shkëlqyer si rast përmendim komunën e Podujevës, Fushë Kosovës dhe Pejës ku si shpërblim për pjesëmarrje dhe aktivitet u shpërblen me ndërtimin e nga një parku.



Në bashkëpunim me anëtarët tanë kemi realizuar një workshop, ku kemi hartuar dokumentet qeverisëse të AFRK-s, organogramin dhe planin e veprimit 2012-2014, duhet theksuar që një pjesë e këtij plani të aktiviteteve është mbështetur nga GIZ-EDYK, përkrahje është ofruar për organizimin e shtatë tryezave në gjashtë regjionet e Republikës së Kosovës.

Këto tryeza janë realizuar me qëllim që ne si AFRK ta kemi një pasqyrë të qartë për gjendjen e sektorit rinor në Kosovë, duke dëgjuar nga vet të rinjtë për sfidat, hallet dhe problemet me të cilat ballafaqohen në realizimin e aktiviteteve të tyre, si dhe të informohemi për shkallën e realizimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë dhe Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj.

Gjetjet tona treguan që niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në punën dhe aktivitetet e Institucioneve Lokale është jo i kënaqshëm, ka shumë pak të rinj dhe organizata që marrin pjesë në dëgjimet publike të rralla që organizojnë komunitat .

Infrastruktura Ligjore e të rinjve ka ngecur dhe nuk zbatohet në shumicën e Komunave, kjo si pasojë e papërgjegjshmërisë së Institucioneve Qendrore dhe Lokale për t'i realizuar obligimet që ua jep Ligji në fuqi.

Sektori jo qeveritar është i ka tendencë të politizimit dhe institucionet Lokale i favorizojnë organizatat që janë pjesë e forumeve politike të udhëheqjes komunale.

Shkalla e vullnetarizmit ka rënë sepse shume organizata kanë vjelë mjete buxhetore në shenjë promovimi të vullnetarizmit dhe kanë instaluar tek të rinjtë ndjenjën që është materializuar vullnetarizmi dhe kjo e pengon në masë të madhe punën vullnetare e cila është element kryesor i nxitjes së qytetarisë aktive.

Duke parë gjendjen në teren dhe duke u bazuar në potencialin që tanimë ne si AFRK kemi dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me KLGJ, si institucion që na ka qëndruar pranë dhe na ka ndihmuar që nga themelimi në kërkime që projekt për qytetari aktive të vazhdohet, sepse resurset që ne posedojmë garantojnë që vazhdimi i këtij projekt do të shkonte në dobi të aktivizimit të të rinjve dhe fuqizimit të rolit të tyre .

IX.

Kosovo Local Government Institute
Address: Rexhep Luci, 15/6 Prishtinë, Kosovë, 10000
E-mail: klg.institute@gmail.com
Tel: +381 38 225 625 or 045-540 164
Web faqja: www.klg-institute.org